

Shtojca 10

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë: 07.10.2021

Drejtuar: "MIKAEL-GRUP" Sh.p.k, adresa Rruga Korçë Libonik-Vashtëmi

Procedura e prokurimit/lotit: **Hapur e thjeshtuar**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-05470-09-16-2021**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës] **“Blerje e elektropompave dhe motorit për pusët në stacionin e pompave Turan” me kohëzgjatje kontrate: deri më 60 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës .**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve te kontrates Nr. 140 datë 20.09.2021.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "ENDI 94" Sh.p.k , nipt K01423004K çmimi prej 2.600.000(dy milion e gjashtëqind mijë) lekë pa TVSH.
2. "IGROUP " Sh.p.k nipt M01406012K çmimi prej 2.750.000(dy milion e shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
3. "ILVA ELEKTRIK" Sh.p.k nipt K01607005N çmimi prej 2.800.000(dy milion e tetëqind mijë) lekë pa TVSH.
- 4 "KLOSI-R COMPANY" Sh.p.k nipt L72120030I çmimi prej 1.760.000 (një milion e shtatëqind e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind) lekë pa TVSH
- 5 "MIKAEL-GRUP" Sh.p.k nipt K64108001G çmimi prej 1.980.000(një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH.
- 6 "R & R GROUP" Sh.p.k nipt K81415001A çmimi prej 1.451.800 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e tetëqind) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "ENDI 94" Sh.p.k , *nipt K01423004K* për arsyt e mëposhtme:

a. -Nuk i plotëson kriteret e përgjithëshme,specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST,


- b. -Operatori ekonomik nuk ka dorëzuar formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST.
- c. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur bilancet e 3 viteve të fundit për të provuar se ka një aktivitet të qëndrueshëm financiar sipas shtojcës 7 të DST.
- d. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2021 sipas shtojcës 7 të DST.
- e. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës sipas shtojcës 7 të DST.
- f. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur certifikatë ISO 9001:2015 për menaxhimin e cilësisë sipas shtojcës 7 të DST.
- g. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për mallin e kërkuar sipas shtojcës 7.
- h. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në sistemin elektronik katalogun/et/ datasheet të prodhuesit të mallit sipas shtojcës 7 të DST.
- i. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur në sistemin elektronik manualet e elektropompave dhe motorit sipas shtojcës 7 të DST.
- j. - Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë specifikim teknik për mallrat e kërkuar sipas shtojcës 5 të DST.

2. **"IGROUP " Sh.p.k nipt M01406012K** për arsyet e mëposhtme:

- a. Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST.
- b. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së fondit limit të kontratës sipas shtojcës 7 të DST.Më konkretisht KVO ka pranuar si furnizim të ngjashëm vetëm faturën me vlerë 2.300.000 lekë pa TVSH në lidhje me furnizimin e pompës zhytëse dhe elektromotorit për Ujësjellës Kanalizime Roskovec.Furnizimet e tjera të dorëzuara nga OE nuk janë furnizime të ngjashme me objektin e këtij tenderi.
- c. Operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike sipas shtojcës 5 të DST për arsye se në specifikimet teknike të paraqitura nga ana jonë, dhe saktësisht në vizatimin përfundimtar ku paraqitet elektromotori, është shprehur qartë që mënyra e lidhjes me pompën

krijohet nëpërmjet 4 bullonave M16 të cilët janë të vendosur në trupin e pompës dhe në trupin e elektromotorit duhet të jenë 4 vrima me diametër Ø18.

Në dokumentacionin e paraqitur nga ana OE për elektromotorin shënohet saktësisht që lidhja kryhet nëpërmjet bullonave "M16x4cop", të cilët filetohen në trupin e elektromotorit,



që do të thotë ndryshim total me elektromotorët egzistues që janë në përdorim pasi pompat egzistuese janë me 4 bullona M16 një trup me pompën.

Nga sa përmëndëm më sipër si kusht teknik është kërkuar saktësisht që vrimat e elektromotorit të jenë Ø18 që në rastin konkret shpie në ndryshim total të mënyrës së lidhjes dhe përmasave që kërkohen.


3. "ILVA ELEKTRIK" Sh.p.k nipt K01607005N për arsyet e mëposhtme:

- a. Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit të kërkuara në DST,
- b. Operatori ekonomik nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3 të DST.

4 "KLOSI-R COMPANY" Sh.p.k nipt L72120030I për arsyet e mëposhtme:

- a. Operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike sipas shtojcës 5 të DST.
- b. Operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike sipas shtojcës 5 të DST për arsye se në specifikimet teknike të paraqitura nga ana jonë, dhe saktësisht në vizatimin përfundimtar ku paraqitet elektromotori, është shprehur qartë që mënyra e lidhjes me pompën krijohet nëpërmjet 4 bullonave M16 të cilët janë të vendosur në trupin e pompës dhe në trupin e elektromotorit duhet të jenë 4 vrima me diametër Ø18.

Në dokumentacionin e paraqitur nga ana e O.E për elektromotorin shënohet saktësisht "



M12x4 Pieces",

që do të thotë ndryshim total me elektromotoret egzistues që kemi në përdorim pasi pompat që kemi janë me **4 bullona M16** një trup me pompën.

Nga sa përmendëm më sipër si kusht teknik kemi kërkuar saktësisht vrimat e elektromotorit **Ø18** që në rastin tuaj shpie në ndryshim total të mënyrës së lidhjes dhe përmasave që kërkohen.

Kujdes: Në specifikimet teknike kemi cilësuar qartë që pjesët e elektropompës do të përdoren edhe si pjesë ndërimi.

5. **R & R GROUP" Sh.p.k nipt K81415001A** për arsyet e mëposhtme:

a. Nuk i plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit dhe specifikimet teknike të kërkuara në DST.

b. Operatori ekonomik nuk ka një aktivitet të qëndrueshëm pozitiv gjatë tre viteve të fundit 2018,2019,2020 sipas përcaktimeve ligjore të VKM 285 datë 19.05.2021 neni 43 pika 4 dhe shtojcës 7 të DST.

c. Operatori ekonomik nuk plotëson specifikimet teknike sipas shtojcës 5 të DST për arsye se në specifikimet teknike të paraqitura nga ana jonë, dhe saktësisht në vizatimin përfundimtar ku paraqitet elektromotori, është shprehur qartë që mënyra e lidhjes me pompën krijohet nëpërmjet 4 bullonave M16 të cilët janë të vendosur në trupin e pompës dhe në trupin e elektromotorit duhet të jenë 4 vrima me diametër **Ø18**. Në dokumentacionin e paraqitur nga O.E për elektromotorin duket qartë se bashkimi midis pompës dhe elektromotorit kryhet me bullona në trupin e elektromotorit, që do të thotë ndryshim total me elektromotoret egzistues që kemi në përdorim pasi pompat që kemi janë me **4 bullona M16** një trup me pompën.

Nga sa përmendëm më sipër si kusht teknik kemi kërkuar saktësisht vrimat e elektromotorit **Ø18** që në këtë rast shpien në ndryshim total të mënyrës së lidhjes dhe përmasave që kërkohen.

Kujdes: Në specifikimet teknike kemi cilësuar qartë që pjesët e elektropompës do të përdoren edhe si pjesë ndërimi.



* * *

I.1 Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë : "**MIKAEL-GRUP**" Sh.p.k, adresa *Rruga Korçë Libonik-Vashtëmi*, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej **1.980.000 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH** është identifikuar si Oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

PERSONI I AUTORIZUAR I ATUROTJETIT KONTRAKTOR

Elia PENDAVINJI